



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1460 prot.

Fushë-Arrëz, më 30. 05. 2025



PROCESVERBAL

Bazuar në ligjin 139/2015 të ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 30.05.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Bardhok Qafa; Besjana Marku; Franc Doda; Lin Predi; Pavlin Qafa; Valentina Lleshaj; Vjollca Tabakaj.**

(8 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje merr pjesë Kryetari i Bashkisë, **Z. Hil Curri**

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Maj 2025! Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen (8 Këshilltarë) e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Para se të fillojmë ju bëjmë me dije se pika 4 e rendit të ditës, “ Projektvendim për disa shtesa në Vendimin Nr.64, datë 23.12.2024, për buxhetin e vitit 2025”, nuk do të trajtohet në mbledhjen e sotme për arsye se Zyra përkatëse nuk ka sjellë dokumentacionin në kohë sipas afateve ligjore në Këshill.

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.05.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 28.04.2025.
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Prill 2025.

4. Projektvendim për disa shtesa në Vendimin Nr.64, datë 23.12.2024, për buxhetin e vitit 2025. (Kjo pikë hiqet nga rendi i ditës për arsyen e cituar më parë)
5. Raport i monitorimit të buxhetit për periudhën Janar - Prill 2025
6. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.
7. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj
8. Të ndryshme.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 1 e rendit të ditës: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.05.2025.

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës pa pikën numër 4, përmes votimit:

➤ Miratohet rendi i ditës me votat e plota të këshilltarëve pjesëmarrës:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 2 e rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 28.04.2025. Nuk ka diskutime.

Atëherë ju ftoj të miratojmë Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 28.04.2025.

➤ Miratohet Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 28.04.2025 me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 3 e rendit të ditës: Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Prill 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

Sidorela Katroshi, Drejtoreshë e Zyrës së Emigracionit dhe Çështjeve Sociale, shpjegon se për muajin Prill 2025 kemi propozuar për ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, 30 familje, me fond 120,666 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 2,011,116 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën 118,630 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 15 familje me fond 50,758 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë .
3. Njësia Blerim , 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Fierzë , 3 familje me fond 19,424 lekë .
5. Njësia Iballë , 5 familje me fond 20,136 lekë .

Sidorela Katroshi, Drejtoreshë e Zyrës së Çështjeve Sociale në Bashki, shpjegon se nuk shtohet në bllok-ndihmën e 6% asnjë familje apo individ për muajin Prill 2025 dhe se largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja: Valter Prela (Njësia Administrative Fierzë) për riaplikim në Ndihmë Ekonomike.

Znj. Katroshi gjithashtu tregon se trajtohen me ndihmën ekonomike prej 6% :

Të gjitha familjet që mund të dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme:

1. Liza Ndue Cenaj
2. Marjana Ded Kacoli
3. Mark Pjeter Marku
4. Misire Shaban Miftaraj
5. Vogel Mark Shpendi
6. Pranvera Nikoll Prebiracevic

Franc Doda, anëtar i Komisionit të Mirëqenies Sociale, shprehet se për këtë muaj nuk ka ndryshime të listës përveçse largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja Valter Prela (Njësia Administrative Fierzë) për riaplikim në Ndihmë Ekonomike. Kështu Komisioni ka rënë dakord me propozimet e Zyrës së Çështjeve Sociale për familjet që përfitojnë 6% të bllok-ndihmës ekonomike sipas listave të sjella.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse Komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Prill 2025 përmes votimit:

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Prill 2025 me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 4 e rendit të ditës: Projektvendim për disa shtesa në Vendimin Nr.64, datë 23.12.2024, për buxhetin e vitit 2025. (Kjo pikë u përjashtua nga shqyrtimi në mbledhjen e sotme në hapje të kësaj mbledhje).

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 5 e rendit të ditës: Raport i monitorimit të buxhetit për periudhën Janar - Prill
2025

Dritan Lika, Drejtor i Zyrës së Financës:

Raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2025 është detyrim sipas ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Ky Raport i paraqitet Ministrisë së Financës çdo 4-mujor dhe Këshillit të bashkisë. Për këtë është respektuar kuadri ligjor për afatet kohore të paraqitjes.

Në mënyrë tabelare janë paraqitur të gjitha të ardhurat e vitit 2025 sipas burimit të financimit dhe sipas VKB për buxhetin e vitit 2025. Këto janë paraqitur edhe në mënyrë grafike siç po e ndiqni edhe në monitor. Siç shihet nga grafiku transfertat zënë pjesën më të madhe të të ardhurave.

Një zë i veçantë janë edhe të ardhurat e veta të Bashkisë. Duhet theksuar fakti që për 4-mujorin e parë ka një nivel të kënaqshëm të realizimit të të ardhurave. Nga 28.5 milion lekë të planifikuara për vitin 2025, vetëm 4-mujorin e parë janë realizuar 16.08 milion lekë, rreth 56% e të ardhurave të gjithë vitit.

Peshën më të madhe në vlerën e të ardhurave e zënë të ardhurat që vijnë nga qirate.

Shpenzimet: Bashkia Fushë-Arrëz ka realizuar shpenzime VKB për buxhetin në vlerën 116 milion lekë. Realizimi i shpenzimeve është në vlerën 50% të buxhetit të miratuar. Këto shpenzime janë paraqitur në mënyrë grafike në monitor.

Duket qartë që pjesa më e madhe e shpenzimeve i përket çështjeve sociale siç është ndihma ekonomike dhe paafësia, përkujdesja.

Më pas vijnë shpenzimet që lidhen me funksionet e transferuara, më pas vijnë shpenzimet e transferuara siç është administrimi i pyjeve, arsimi bazë etj, e në fund janë shpenzimet për të gjitha transfertat e tjera.

Shpenzimet janë paraqitur përveçse në nivel programesh edhe në nivel artikujsh, shpenzimet për projektet, për pagat për sigurimet shoqërore, për investimet, për shpenzimet operative, transfertat të ndryshme dhe transfertat tek individë.

Duhet të theksohet fakti që bashkia Fushë-Arrëz nuk ka krijuar asnjë detyrim të prapambetur gjatë kësaj periudhe.

Kjo ishte një panoramë e shkurtër lidhur me Raportin e monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2025.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Taksat a janë progresive?

Dritan Lika, Drejtor i Zyrës së Financës:

Duke pasë parasysh që vetëm për 4-mujorin e parë janë mbledhur rreth 56% e planit vjetor të ardhurave nga taksat, shpresojmë që në fund të vitit të kemi realizim 100% të të ardhurave.

Franc Doda, anëtar i Këshillit:

Këto taksat e pastrimit apo të ndriçimit si janë bërë?

Dritan Lika, Drejtor i Zyrës së Financës:

Normalisht Bashkia nuk ka përdorur metoda shtrënguese për mbledhjen e këtyre të taksave. Praktikisht janë bërë disa herë fushata sensibilizimi por këto taksa nuk kanë penalizuar askënd lidhur me shërbimet që ofron Bashkia.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak. Ndikim në të ardhurat më shumë e kanë bizneset e mëdha.

Dritan Lika, Drejtor i Zyrës së Financës:

Praktikisht ato janë korrekt në shlyerjen e detyrimeve.

Hil Curri, Kryetar i bashkisë:

Jemi komunitet i vogël por kemi arritur të mbledhim taksat kënaqshëm.

Sa i përket pikës 4 që u përjashtua nga shqyrtimi në mbledhjen e sotme do të bëjmë kërkesë Këshillit që ta shqyrtojmë në një mbledhje jashtë radhe.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 6 e rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.

Nuk ka vendime të kthyera nga Prefektura për rishqyrtim.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pikat me numër 7 dhe 8, të rendit të ditës nuk kanë objekt për diskutim.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



Bejana Moriku
Valentina Lleshaj
Gjolca Tabaka
Barolhok
Pardun
Lin Prenoli

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

